



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 3738/5 Prot.

Tiranë, më 21 . 07 . 2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 80, datë 21 / 07 2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "2T" shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim për qëllime kualifikimi.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): Operatori Ekonomik "2T" Shpk, me NIPT K01731001M, me adresë: Rruga "Asim Vokshi" Nd. 14, Hyrja 4, Ap 5, Tiranë.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

APP është vënë në lëvizje nga kërkesa e paraqitur nga shoqëria "Victoria Invest" Shpk, e cila ka kërkuar nga APP që të nisë procedimin administrativ për shoqërinë "2T" Shpk, për keqinformim në Lotin IV me objekt: "Mirëmbajtje me performancë K/Sauk - Sanatorium, Sauk - Km 29 - rot. Re Shijon - Ura e Zaranikës, Km 22 - Qytezë Krrabë - Objekti X, Rotondo Sauk - Sauk i Vjetër, Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj, Vaqarr - Vishaj (84.6 km), të procedurës së prokurimit "Tender i Kufizuar" me objekt: "Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror" (e ndarë në 10 Lote) të zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, faza e parë në datë 07.08.2020 dhe faza e dytë në datë 19.10.2020.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se, nuk ndodhemi në kushtet e keqinformimit, pra të nenit 78/1/a të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 80, datë 21 . 07 . 2022, APP ka vendosur të mospërjashtojë operatorin ekonomik "2T" shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike.